



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 577/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, kundër Komisionerit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

ARSYETIM

Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) në Prishtinë ka parashtruar ankesë, duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në QV 2006a VV 01R në lagjen “Tusuz” në Prizren, pas mbylljes së vendvotimit dhe gjatë numërimit të votave komisionari Rrezak Krasniqi nga radhët e subjektit politik PDK ka ndikuar tek vëzhguesit duke përdorur fjalë kërcënuese, fyese dhe duke ia pamundësuar pamjen e fletëvotimeve gjatë numërimit të votave.

Sipas parashtruesit të ankesës komisionari i PDK-së ka manipuluar me vota në prezencën e komisionarëve dhe vëzhguesve të partive politike dhe vëzhguesve të OJQ-ve i cili disa herë ka kërkuar nga vëzhguesit e BIRN-it që të largohen nga VV.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë kanë shkelur nenin 180 të KPK-së si dhe nenin 34 të LZP-së

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga BIRN, duke pretenduar se kryesuesi i VV 2006 /a ka shkaktuar parregullsi gjatë procesit të votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e subjektit politik BIRN, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse përveç disa emrave si: Petrit Kryeziu, Qazim Hasanaj, Blend Shala, Agim Thaqi, Tamil Krasniqi, Rina Duçi Nafi Gashi, Rena Ibrahim, Driton Gashi dhe Hyrmete Hoti lidhur me parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 577/2010 më datën 16.12.2010.

